



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

Prishtinë, 03.10.2022

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

PËRMBAJTJA:

NENI 1 - QËLLIMI I RREGULLORES	3
NENI 2 - FUSHËVEPRIMI	3
NENI 3 - LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL.....	3
NENI 4 - KRITERET	4
NENI 5 - VENDIMI PËR ÇMIMET.....	6
NENI 6 - POENTIMI.....	6
NENI 7 - ÇERTIFIKATA E ÇMIMEVE.....	7
NENI 8 - SHPËRBLIMI FINANCIAR.....	7
NENI 9 - PROCEDURA.....	7
NENI 10 - ZBATIMI	8
NENI 11 - DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE.....	8

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Mbështetur në Nenin 23 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së më 03.10.2022 miraton këtë:

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

NENI 1 - QËLLIMI I RREGULLORES

1. Kjo Rregullore përcakton kriteret, kushtet dhe procedurën për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll në Republikën e Kosovës për klubet dhe anëtarët e FBK-së.
2. Gjithashtu Rregullorja përcakton llojet e çmimeve dhe shpërblimet për secilin çmim.

NENI 2 - FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës, klubet dhe anëtarët e FBK-së.

NENI 3 - LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL

1. Federata e Basketbollit të Kosovës bën shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, përmes këtyre çmimeve:
 - 1.1. Basketbollisti i vitit;
 - 1.2. Basketbollistja e vitit;
 - 1.3. Pesë (5) basketbollistët më të dalluar të vitit;
 - 1.4. Pesë (5) basketbollistet më të dalluara të vitit;
 - 1.5. Skuadra më e mirë në konkurrencën e meshkujve;
 - 1.6. Skuadra më e mirë në konkurrencën e femrave;
 - 1.7. Trajneri më i mirë i vitit;
 - 1.8. Shpresa e vitit tek djemtë;
 - 1.9. Shpresa e vitit tek vajzat;
 - 1.10. Gjyqtari i vitit;
 - 1.11. Punëtori më i dalluar i vitit;
 - 1.12. Mirënjohje të tjera.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





2. Çmimet e themeluara në paragrafin 1 të këtij Neni ndahen çdo vit dhe ndarja bëhet në një ceremoni solemne të organizuar nga FBK në muajin Dhjetor.

NENI 4 - KRITERET

1. Kriter për shpalljen e basketbollistit dhe basketbollistes së vitit janë rezultatet e arritura gjatë një viti kalendarik në këto gara:

1.1. Gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women)

1.2. Gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës)

1.3. Gara me ekipin nacional

2. Kriter për shpalljen e pesë (5) basketbollistëve dhe pesë (5) basketbollisteve më të dalluara janë rezultatet e arritura gjatë një viti kalendarik në këto gara:

2.1. Gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women)

2.2. Gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës)

2.3. Gara me ekipin nacional

3. Kriter për shpalljen e skuadrës së vitit për meshkuj dhe femra janë rezultatet e arritura gjatë një viti kalendarik në këto gara:

3.1. Gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women)

3.2. Gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës)

4. Kriter për shpalljen e trajnerit të vitit janë rezultatet e arritura të klubeve gjatë një viti kalendarik në këto gara:

4.1. Gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women)

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





4.2. Gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës)

4.3. Gara me ekipin nacional

5. Kriter për shpalljen e shpresave të vitit në konkurrencën e djemve dhe vajzave janë rezultatet e arritura gjatë një viti kalendarik në këto gara:

5.1. Gara vendore

5.2. Gara me ekipin nacional

6. Kriter për shpalljen e gjyqtarit të vitit janë paraqitjet gjatë një viti kalendarik në këto gara:

6.1. Gara ndërkombëtare

6.2. Gara vendore

7. Kriter për shpalljen e punëtorit më të dalluar janë rezultatet e arritura gjatë një viti kalendarik në këto gara:

7.1. Gara ndërkombëtare

7.2. Gara vendore

8. Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushen nga laureatët e çmimeve në basketboll janë:

8.1. Basketbollisti/basketbollistja, shpresat, trajneri, gjyqtari, punëtori i dalluar sportiv etj duhet të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës.

8.2. Basketbollisti/basketbollistja që ka mbush moshën 12 vjeç deri në ditën që i mbushë 18 vjeç konsiderohet shpresë e basketbollit dhe i llogariten të gjitha rezultatet e arritura deri në ditën kur i mbush 18 vjeç.

9. Cikli për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll nis me fillimin e vitit dhe përfundon në përmbyllje të po njëjtit vit.

10. Nëse gjatë vlerësimit të Komisionit, pikët në ndonjërin kategori janë të barabarta, përparësi duhet të ketë gara ndërkombëtare që ka nivelin më të lartë, ose gara vendore që ka nivelin më të lartë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 5 - VENDIMI PËR ÇMIMET

1. Bordi Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës cdo cit emëron Komisionin për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll.
2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, sipas kësaj përbërje:
 - 2.1. Një anëtar i Bordit Ekzekutiv të FBK-së;
 - 2.2. Një ish-basketbollist eminent vendor;
 - 2.3. Një ish-basketbolliste eminente vendore; dhe
 - 2.4. Dy gazetarë/e të sportit (preferohet nga fusha e basketbollit), të cilët i propozon Shoqata e Gazetarëve Sportiv të Kosovë.
3. Kryesues i Komisionit është anëtari i Bordit Ekzekutiv të FBK-së (konform Rregullores së Komisioneve Këshillëdhënëse të FBK-së).
4. Në mbledhjet e Komisionit mund të merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë e këshillëdhënësit dhe pa të drejtë vote apo vendim marrjeje (konform Rregullores së Komisioneve).
5. Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni i rekomandon Bordit Ekzekutiv të FBK-së për marrje të vendimit.
6. Bordi Ekzekutiv me shumicë të votave vendosë ti pranoj ose ti refuzoj rekomandimet e Komisionit.
7. Bordi Ekzekutiv nxjerr vendimin për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, pas rekomandimit të Komisionit.

NENI 6 - POENTIMI

1. Për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, Komisioni duhet të vendos sipas poentimit të cilin e përcakton Bordi i FBK-së.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 7 - ÇERTIFIKATA E ÇMIMEVE

1. Çmimet vjetore të të shpërblyerve përmbajnë një certifikatë të nënshkruar nga Kryetari i FBK-së, një statuetë, dhe një çek në vlerën monetare të përcaktuar si në Nenin 8 të kësaj Rregulloreje.
2. Çertifikata duhet të përmbajë: logon e Federatës së Basketbollit të Kosovës, emrin dhe mbiemrin e laureatit të çmimit, emrin e çmimit, numrin dhe datën e vendimit për dhënien e çmimit, titullin, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e autoritetit që e nënshkruan dhe vulën e FBK-së.

NENI 8 - SHPËRBLIMI FINANCIAR

1. Çmimet vjetore për basketboll nga FBK shoqërohen edhe me shpërblim financiar.
2. Lartësinë e shpërblimit financiar për secilin çmim e përcakton Bordi Ekzekutiv i FBK-së për do vit.

NENI 9 - PROCEDURA

1. Federata e Basketbollit e Kosovës u dërgon shkresë klubeve të saj, përmes të cilës kërkon nominimin e laureatëve të vitit në basketboll për të gjitha çmimet nga një nominim.
2. Kërkesa për nominim duhet të dërgohet më së largu më datën 10 Nëntor të vitit pasues dhe klubet duhet ti përcjellin nominimet e tyre brenda shtatë (7) ditëve.
3. Klubet kanë të drejtë të nominojnë nga një laureat për secilin çmim, pra një basketbollist, një basketbolliste për të mirët e vitit, pesë basketbollistë më të dalluar të vitit, pesë basketbolliste më të dalluara të vitit, një ekip të meshkujve (ekipet e meshkujve), një ekip të femrave (ekipet e femrave), një shpresë olimpikë tek djemtë, një shpresë olimpikë tek vajzat, një trajner, një gjyqtar, një punëtor sportiv etj.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





4. Bordi Ekzekutiv i FBK-së ka të drejtë të nominoj nëse e sheh të arsyeshme nga një laureat për secilin çmim.
5. Nominimi nga klubet përkatëse, duhet ti bëhet përmes formularit për nominimin e laureatit të vitit në basketboll, të cilin e përgatitë zyra ekzekutive e FBK-së dhe e miraton Bordi i FBK-së.
6. Komisionit duhet të vlerësojë aplikimet brenda shtatë (7) ditëve nga dita e mbylljes së aplikimit.
7. Ceremonia e shpalljes së laureatëve të vitit në basketboll duhet të bëhet gjatë muajit Dhjetor të vitit pasues, para Festave të Fundvitit.

NENI 10 - ZBATIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës, klubet dhe anëtarët e FBK-së.

NENI 11 - DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FBK-së.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i propozon Sekretari i Përgjithshëm, të cilat i miraton Bordi i FBK-së.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

